

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit

Nr1 i prokurimit	217-26-2696-2-2-1
Nr i brendshëm	217-26-007-2-2-1

Titulli: Shërbimet, Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit për nevojat e FSK-së.

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Besim A.Zejnullahu B.I

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Regakut,p.n

(Adresa)

Ferizaj

(Vendi)

044138490

(Numri Telefonit)

70000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Besim Zejnullahu


(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ekoddd@hotmail.com

(Adresa elektronike)

25.09.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

BESIM A. ZEJNULLAHU B.I.
"EKO-DDD"


(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratë 27.04.2026
- Afati i fundit për dorëzim të tenderëve 19.06.2026 në 14:00:00 orë
- Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët ☒
- Njoftimi për dhënie të kontratës dhe letrën standarde për tenderuesit e eliminuar me dt.10.07.2026
- Kërkesa për ri-shqyrtim me dt.12.07.2026
- Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim me dt. 14.07.2026
- Ankesa ne OSHP 22.07.2026
- Vendimi i OSHP-se 07.09.2026
- Njoftimi mbi vendimin e AK-se dhe Letra standarde për tenderuesin e eliminuar me 11.09.2026
- Kërkesa për rishqyrtim të vendimit 14.09.2026
- Vendimi i kërkesës për rishqyrtim 17.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Kundër vendimit për Anulim të tenderit dhe Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, të datës 11.09.2026, të nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e Dezinsektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit për nevojat e FSK-së”, me numër të prokurimit 217-26-2696-2-2-1 dhe numër të brendshëm 21700/26/007/221, në si OE Besim A. Zeinullahu B.I. jem eliminuar nga procedura e prokurimit andaj kemi parshtruar kërkesë për ri-shqyrtim tek AK- [MINISTRIA E MBROJTJES](#). me dt. 14.09.2026.

AK- [MINISTRIA E MBROJTJES](#) me dt. 17.09.2026 na njofton me vendimin mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit : Shërbimet, Dezinsektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit për nevojat e FSK-së me nr. të prokurimit 217-26-2696-2-2-1 me arsyetimin se kërkesa për ri-shqyrtim është e pa bazuar.

Bazuar në dispozitat e nenit 109 të LPP parashtror ankesë kundër vendimit për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim si dhe kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe letrës standarde si OE i eliminuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Dispozitat e shkelura:**
- **Neni 1**
- **Neni 6**
- **Neni 7**
- **Neni 56**
- **Neni 59**
- **Neni 72 dhe udhëzuesi Nr.002/2024**
- **Neni 108/A**

Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund

të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në pajtim me dispozitat e nenit 109 të LPP-ës parashtrojmë këtë ankesë kundër vendimit të AK **MINISTRIA E MBROJTJES** mbi refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim si dhe kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe letrës standarde si OE i eliminuar. AK me rastin e rishqyrtimit të kërkesës sonë nuk ka vepruar konform nenit 108A të LPP me qëllim të evitimit të gabimeve me rastin e vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave, por e njëjta ka refuzuar kërkesën si të PA BAZUAR.

ANKESË KUNDËR VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES me të cilin është refuzuar Kërkesa jonë për Rishqyrtim dhe janë lënë në fuqi konstatimet për eliminimin e ofertës sonë.

Konsiderojmë se Vendimi i AK-së është i pabazuar në fakte dhe në interpretimin e kërkesave të Dosjes së Tenderit, si dhe se gjatë rivlerësimit janë interpretuar në mënyrë të zgjeruar kërkesat e DT-së dhe janë vendosur kërkesa/dëshmi të cilat nuk janë përcaktuar qartë si të detyrueshme në dokumentet e tenderit.

Po ashtu, në disa pika, arsyetimi i AK-së bie ndesh me konstatimet dhe çështjet e trajtuara në Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0519, datë 07.09.2026, vendim i cili ka qenë pjesë e kësaj procedure.

Për këto arsye, parashtrojmë këto pretendime ankimore

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 1 – “POWER MAX OSE GLUE TRAP”

AK-ja e ka refuzuar pretendimin tonë duke arsyetuar se OE-ja nuk ka përcaktuar qartë produktin e ofruar, pasi ka paraqitur “Power Max ose Glue Trap”.

Ky arsyetim nuk qëndron, pasi kjo çështje është shqyrtuar më parë nga OSHP-ja në Vendimin nr. **2026/0519, datë 07.09.2026**, ku Paneli Shqyrtues e ka aprovuar ankesën tonë si të bazuar.

Eksperti ka konstatuar konkretisht se “Power Max” dhe “Glue Trap” janë paraqitur si produkte alternative me funksion dhe përdorim të njëjtë, ndërsa për “Glue Trap” janë dorëzuar në ofertë **A-Testi dhe MSDS-ja**, të cilat kanë qenë në dispozicion të Komisionit të Vlerësimit.

Në vendimin e ri, AK-ja nuk ka paraqitur ndonjë fakt apo dokument të ri që do t'i ndryshonte këto konstatime, por vetëm ka riformuluar arsyen e eliminimit duke e paraqitur çështjen si “mosidentifikim të produktit”.

Dokumentacioni i ofertës ka qenë i njëjtë dhe A-Testi dhe MSDS-ja për “Glue Trap” kanë qenë pjesë e ofertës që nga momenti i dorëzimit.

Për më tepër, kjo çështje është trajtuar më parë në Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0519, datë 07.09.2026, faqe 19

Prandaj, pretendimi se oferta është e papërgjegjshme vetëm për shkak të gjoja paqartësisë në emërtimin e produktit nuk qëndron, pasi AK-ja nuk ka identifikuar asnjë mospërputhje konkrete të produktit “Glue Trap” me kërkesat e tenderit.

Për këtë arsye kërkojmë që Paneli Shqyrtues të vlerësojë përmbajtjen konkrete të DT-së, sqarimeve zyrtare dhe dokumentacionit të ofertës dhe të konstatojë që AK nuk ka bazë ligjore dhe faktike për shpalljen e ofertës të papërgjegjshme.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 2 – “CLEANISEPT” DHE A-TESTI

AK-ja e ka refuzuar pretendimin tonë me arsyetimin se A-Testi për produktin “Cleanisept” nuk është lëshuar në emër të OE-së.

Ky arsyetim është i pabazuar, pasi në Dosjen e Tenderit nuk është përcaktuar që A-Testi duhet të jetë domosdoshmërisht i lëshuar në emër të Operatorit Ekonomik ofertues. Kërkesa ka qenë që për preparatet dezinfektuese të ofrohet **Certifikata e A-Testit**.

Ne kemi dorëzuar A-Testin për produktin “Cleanisept”, duke përmbushur kërkesën e përcaktuar në DT. AK-ja nuk mund të shtojë gjatë rivlerësimit një kusht të ri, të cilin nuk e ka përcaktuar në DT.

Për më tepër, kjo çështje është trajtuar edhe në Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0519 faqe 20.

Për këto arsye, kërkojmë që pretendimi nr. 2 të konsiderohet i bazuar dhe vendimi i AK-së në këtë pjesë të anulohet, duke obliguar AK-në të veprojë në përputhje me DT-në, LPP-në dhe Vendimin nr. 2026/0519.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 3 – GJENERATORI MMT HUNTER

AK-ja na ka eliminuar me arsyetimin se nuk është paraqitur dokumentacion teknik i mjaftueshëm për gjeneratorin MMT Hunter.

Ky arsyetim është i pabazuar, pasi në DT është kërkuar që për pajisjet të dëshmohej posedimi përmes **Faturës, DUD-it ose marrëveshjes së qirasë**, ndërsa për pajisjen është kërkuar “Gjeneratorë Ultra Low Volume – ULV, minimum 1 copë”.

Ne kemi dorëzuar listën e pajisjeve dhe dëshminë e posedimit të gjeneratorit MMT Hunter, në përputhje me kërkesat e DT-së. Kërkesa për dokumentacion teknik shtesë nuk është përcaktuar shprehimisht si dokument i detyrueshëm në DT.

AK-ja nuk mund të vendosë gjatë rivlerësimit një kërkesë shtesë dokumentare që nuk ka qenë e përcaktuar në DT, aq më tepër kur një dokument i tillë nuk është kërkuar as gjatë procesit të rivlerësimit. Për këtë arsye, për të eliminuar çdo paqartësi, bashkë me këtë parashtrësë i dorëzojmë Panelit Shqyrtues dhe ekspertit specifikacionin teknik të pajisjes

MMT Hunter, i cili dëshmon qartë se pajisja është Gjenerator Ultra Low Volume – ULV, në përputhje me kërkesën përkatëse të DT-së.

Për këto arsye, kërkojmë që pretendimi nr. 3 të konsiderohet i bazuar dhe vendimi i AK-së në këtë pjesë të anulohet, ndërsa oferta jonë të rivlerësohet në përputhje me DT-në dhe LPP-në.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 4 – PAJISJA BBDI 00

AK-ja na ka eliminuar me arsyetimin se nuk është paraqitur dëshmi teknike e mjaftueshme për pajisjen **BBDI 00 – Detektor për insekte**.

Ky arsyetim është i pabazuar, pasi në DT është kërkuar “Detektor për insekte – minimum 1 copë”, ndërsa si dëshmi për posedimin e pajisjes janë kërkuar **Fatura dhe DUD-i**. Ne kemi dorëzuar listën e pajisjeve, fotografinë e pajisjes, Faturën dhe DUD-in, duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në DT.

Për më tepër, në sqarimin e datës **25.05.2026, përgjigjja nr. 6**, AK ka sqaruar se me “Detektor për insekte” nënkupton pajisje profesionale për detektimin, gjurmimin dhe monitorimin e insekteve të dëmshme,

ndërsa në DT-në e përmirësuar të datës **09.06.2026** ka kërkuar që kontrollimi dhe gjurmimi i insekteve të bëhet me pajisje profesionale adekuate – “Detektor për insekte – min. 1 copë”, duke kërkuar për këtë pajisje si dëshmi vetëm **Faturën dhe DUD-in**.

AK-ja nuk mund të vendosë gjatë rivlerësimit një kërkesë shtesë dokumentare që nuk ka qenë e përcaktuar në DT, aq më tepër kur një dokument i tillë nuk është kërkuar as gjatë procesit të rivlerësimit. Për këtë arsye, për të eliminuar çdo paqartësi, bashkë me këtë parashtrësë i dorëzojmë Panelit Shqyrtues dhe ekspertit specifikacionin teknik të pajisjes **Detektor për insekte**.

Kjo çështje është trajtuar më parë në Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0519, faqe 22

Për këto arsye, kërkojmë që pretendimi nr. 4 të konsiderohet i bazuar dhe oferta jonë të rivlerësohet në përputhje me DT-në, LPP-në dhe Vendimin nr. 2026/0519.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 5 – ZBATIMI I NENIT 62.1.1 TË LPP-SË

AK-ja pretendon se ekzistojnë mospërputhje ndërmjet dokumenteve të procedurës dhe specifikimeve të publikuara në E-Prokurim, duke u thirrur në nenin 62.1.1 të LPP-së. Mirëpo, ky arsyetim nuk ka qenë pjesë e vendimit fillestar për anulim, por është paraqitur vetëm pas Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0519, me të cilin lënda është kthyer në rivlerësim.

AK-ja gjithashtu ka paraqitur një dokument me sipërfaqe të ndryshme nga ato të përcaktuara në DT, pa dëshmuar se ky dokument ka qenë pjesë e dokumentacionit të tenderit para përfundimit të afatit të ofertimit. Të gjithë OE-të kanë ofertuar mbi bazën e DT-së dhe specifikimeve të publikuara nga vetë AK-ja, ndërsa sasinë në DT janë përcaktuar shprehimisht si indikative, me mundësi devijimi prej $\pm 30\%$, dhe kontrata është paraparë për tri vite.

Për më tepër, në këtë fazë vetem ne si OE kemi vazhduar validitetin e ofertës, ndërsa OE-të e tjera nuk e kanë vazhduar atë. Prandaj, anulimi i procedurës pikërisht në këtë fazë, mbi bazën e arsyeve të reja dhe të dokumenteve që nuk është dëshmuar se kanë qenë pjesë e DT-së në kohën e ofertimit, e cenon drejtpërdrejt interesin e tonë dhe na mohon mundësinë për vazhdimin e procedurës dhe potencialisht për shpërblimin me kontratë.

AK-ja nuk mund të krijojë pas përfundimit të ofertimit një bazë të re faktike për anulim dhe as OE-ja nuk mund të dëmtohet për shkak të gabimeve apo mospërputhjeve në dokumentacionin e përgatitur nga vetë AK-ja. Po ashtu, nuk është dëshmuar përmbushja e kushteve të nenit 62.1.1 të LPP-së dhe as domosdoshmëria e anulimit të aktivitetit.

Për këto arsye, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që ta konsiderojë pretendimin të bazuar, të mos e pranojë anulimin dhe të urdhërojë vazhdimin e procedurës me rivlerësim, në përputhje me LPP-në, DT-në dhe Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0519.

Duke u bazuar në pretendimet, sqarimet dhe deshmite e cekura me larte, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që, pas shqyrtimit të dokumentacionit të plotë të aktivitetit të prokurimit, Vendimit të AK-së, Kërkesës sonë për Rishqyrtim, përgjigjes së AK-së, Dosjes së Tenderit, sqarimeve të publikuara dhe Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0519, datë 07.09.2026 të cilat janë evidente, të preکشme kërkojmë nga OSHP të merr :

V E N D I M

1. APROVOHET SI E BAZUAR ankesa jone OE. “Besim A. Zejnullahu B.I ” lidhur me tenderin Shërbimet, Dezinsektimit, Deratizimit për nevojat e FSK-së me nr. të prokurimit 217-26-2696-2-2-1,

2. ANULOHET njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

3. SHPËRBLEHEMI me kontratë ne si OE i përgjegjshëm pasi që ne i plotësojmë kriteret e kërkuara të DT-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet e konstatuara deri me tani kapin shume rreth 500 €

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.